


maj 2017

gap | analizë



**PËRGATITJA PROFESSIONALE
PËR TREGUN E PUNËS**

Analizë e sektorit privat të shërbimeve

Përbledhje ekzekutive

Shkalla e papunësisë së të rinjve në Kosovë është 52.2%, ndërkaq shkalla e përgjithshme e papunësisë është 28.7%, duke e bërë Kosovën njërin ndër vendet me papunësinë më të lartë në Evropë. Niveli i lartë i papunësisë i shoqëruar me mospërputhje të aftësive të fituara nga institucionet arsimore dhe atyre të kërkaura nga sektori privat çon vandin në një situatë të palakmueshme socio-ekonomike.

Të gjeturat e këtij hulumtimi vërtetojnë mungesën e aftësive profesionale në industrinë e shërbimeve të sektorit privat, ku nga 92% të kompanive të anketuara të cilat kanë punësuar punëtorë të rinj gjatë tri viteteve të fundit, 82.1% kanë hasur në vështirësi të gjejnë punëtorë të kualifikuar. Mospërputhja e aftësive ka bërë që në 53% të kompanive të punësohen punëtorë më pak të kualifikuar për të plotësuar pozitat e punës, në 57.1% të tyre të pengohet zhvillimi i shërbimeve të reja dhe në 42.1% të kompanive të ulet produktiviteti.

Aftësitë e duhura për kryerjen e detyrave për një pozitë, më së shumti konsiderohet të jenë mësuar si kombinim i shkollimit dhe punës apo të jenë përforcuar gjatë punës, por vetëm për disa detyra të 4 pozitave nga total 24 të përfshira në anketë, konsiderohet se aftësitë për kryerjen e detyrave për pozitat e përzgjedhura janë mësuar në shkollë. Hulumtimi po ashtu nxjerr në pah aftësitë e përgjithshme ndërsektorale më të kërkaura në industrinë e shërbimeve të cilat janë: njohja e gjuhëve të huaja, dhënia e shpejtë e informatës, mendimi kritik, komunikimi i mirëfilltë, mendimi logjik, zgjidhja e problemeve, veticinitativa, kreativiteti, puna në ekip, përdorimi i teknologjisë informative dhe gjithanshmëria.

Sipas statistikave të brendshme të Agjencisë për Arsim dhe AftësimProfesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr), shumica e të diplomuarve nga qendrat e kompetencës të menaxhuara nga ky institucion nuk janë punësuar, ndërkaq nga të punësuarit shumica bëjnë punë jashtë profesionit. Për më tëpër, hulumtimi ynë tregon se sektori privat në industrinë e shërbimeve nuk ka fituar ende besimin në cilësinë e të diplomuarve nga këto institucione.

Kjo analizë arrin në përfundim që programet arsimore në Kosovë nuk prodhojnë kohortë të kualifikuara dhe të nevojshme për tregun e punës dhe si rrjedhojë rekomanodon koordinim më të mirë të kurrikulumeve me kërkesat e tregut të punës duke përfshirë sektorin privat në procesin e hartimit të politikave të edukimit, koordinim të punës së institucioneve të arsimit dhe punësimit, ri-trajnim të mësimdhënësve përfushat e nevojshme si dhe bashkëpunim me portalet e punës për shrytëzimin e të dhënavë të tyre mbi aftësitë më të kërkaura nga kompanitë që operojnë në Kosovë.

Hyrje

Ky hulumtim përfshin një pasqyrë të shkurtër të arsimit në Kosovë me fokus të veçantë në arsimin profesional në nivel të shkollave të mesme të larta dhe trajnimeve profesionale. Hulumtimi përfshin një anketë të realizuar me 28 biznese në industrinë e shërbimeve. Këto biznese janë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe përfshijnë këto veprat e biznesore: qendra të thirrjeve, përkthimi dhe interpretimi, dizajn, hulumtim të tregut dhe realizim të sondazheve, arkitekturë, marketing, këshillim të bizneseve, marrëdhënie me publikun, kontabilitet dhe auditim, shërbime juridike, vlerësim të riskut dhe dëmit dhe subjekte të ngashme. Ky hulumtim me qëllim është fokusuar vetëm tek sektori i shërbimeve meqë institucionet dhe organizatat tjera tashmë kanë botuar hulumtime mbi sektorët e tjera ekonomik.¹



FIGURA 1. PËRFAQËSIMI I SEKTORËVE EKONOMIKË NË ANKETË

Sa i përket madhësisë së bizneseve që kanë qenë pjesë e këtij hulumtimi, 52% e mostrës janë mikrondërmarrje, 41% janë ndërmarrje të vogla, 3% janë ndërmarrje të mesme dhe 4% janë ndërmarrje të mëdha. Në Kosovë ekzistonjë gjithsej 2,882 mikrondërmarrje, 28 ndërmarrje të mesme dhe të vogla së bashku, ndërkëq nuk ka ndërmarrje të mëdha sipas të dhënave përmes tremujorin e parë të vitit 2017. Duke u nisur nga kjo ndarje, përfaqësimi i bizneseve në anketë përkon edhe me përbërjen e sektorit privat në Kosovë.

Pjesa e parë e anketës fokusohet në të dhëna të përgjithshme mbi kompaninë; vështirësinë e gjetjes së punëtorëve të kualifikuar sipas nivelit të edukimit dhe aftësive të buta dhe të transferueshme; ofrimin e

¹ Shih: Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP), "Vlerësimi i nevojave për shkathtësi: Identifikimi i nevojave të punëdhënësve në gjashtë sektorë ekonomikë në Kosovë" dhe Demokraci për Zhvillim (D4D): "Incentiva për Reforma: Rritja e mundësive për studentët dhe të diplomuarit e QAP-ave në tregun e punës"

trajnimeve brenda kompanisë dhe kërkesat për shkollimin formal të punëtorëve në bazë të pozitave; njohuritë e tyre mbi qendrat e kompetencës dhe shkollat profesionale si dhe gatishmërinë për të punësuar të diplomuarit e këtyre qendrave. Pjesa e dytë e anketës është fokusuar në 24 pozita të punës të cilat janë vlerësuar se mund të ekzistojnë në këto biznese. Të anketuarit janë përgjigjur vetëm për ato pozita të cilat ekzistojnë në kompaninë e tyre. Pjesa e tretë e anketës përfshin opinionet e të anketuarve mbi aftësitë më të këruara në industrinë e shërbimeve.

Përshkrimi i detyrave sipas pozitës është bazuar në kategoritë ISCO – 08 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), mirëpo janë shkurtuar dhe thjeshtëzuar për të qenë më të aplikueshme në rastin e Kosovës. Pjetjet janë strukturuar në atë mënyrë ku të anketuarit kanë pasur mundësinë të zgjedhin nëse punëtorwt për pozitën në fjalë i kryejnw detyrat apo jo dhe sipas pohimit apo mohimit të përzgjedhin nëse aftësitë për të kryer ato detyra janë mësuar gjatë shkollimit, mësuar gjatë punës, përforcuar gjatë punës, apo është krijuar nga shkollimi dhe puna së bashku, ose nëse aftësitë për t'i kryer detyrat janë të panevojshme apo nuk janë mësuar as në shkollë as në punë.

Ky hulumtim përfshin edhe një rast studimi ku ofrohen të dhëna mbi kompaninë Baruti, një qendër e thirrjeve që ofron shërbime për klientë në vende gjermano-folëse.

Arsimi profesional në Kosovë

Në Kosovë, arsimi është i ndarë në tri nivele të përgjithshme: arsimi i lartë, arsimi parauniversitar dhe arsimi profesional. Arsimi i lartë përfshin nivelin akademik pas përfundimit të shkollës së mesme, pra studimet themelore tre vjeçare pas inkorporimit të sistemit të Bolonjës, studimet e magjistraturws dhe ato të doktoraturës. Ndërkaq niveli parauniversitar përfshin nivelin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë dhe në arsimin profesional bëjnë pjesë shkollat e mesme të larta profesionale dhe qendrat e kompetencës.

Numri i institucioneve arsimore publike në Kosovë është gjithsej 1,114, përfshirë këtu 43 institucione të nivelit parashkollor, 946 shkolla filllore dhe të mesme të ulëta, 119 shkolla të mesme të larta dhe 6 shkolla speciale.² Nga shkollat e mesme janë gjithsej 65 shkolla profesionale.³

² Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, "Shënim Statistikore 2016-17 Arsimi Parauniversitar" <<http://bit.ly/2oV8i09>>

³ Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), "Raport mbi rezultatet e hulumtimit rrëth shkollave profesionale dhe qëndrimit të tyre ndaj sigurimit të cilësisë kornizës kombëtare të kualifikimeve dhe autoritetit kombëtarë të kualifikimeve" <<http://bit.ly/2oWnDs6>>

Arsimi profesional po ashtu ofrohet përmes sektorit privat. Sipas të dhënave nga bizneset e regjistruara dhe aktive në Kosovë, duke përjashtuar arsimin parashkollar, janë 648 entitete në sektorin privat që ofrojnë shërbime të trajnimit dhe arsimit.⁴

Nivelet sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) janë: niveli 8 – doktoraturë; niveli 7 – master; niveli 6 – bachelor/universitar; niveli 5 – parauniversitar 2 vjeçar apo shkollë e lartë profesionale; niveli 4 – Matura dhe Diploma e përgjithshme/Diploma profesionale në AAP ; niveli 3 – Arsimi i përgjithshëm (shkolla e mesme e lartë), klasët 9-12 dhe/apo AAP ekuivalent; niveli 2 – Arsimi i përgjithshëm (shkolla e mesme e ulët), klasët 6-9 dhe/apo AAP ekuivalent; niveli 1 – Arsimi i përgjithshëm (shkolla filllore), klasët 1-5 dhe/apo AAP ekuivalent.

Shkollimi i mesëm i lartë profesional është i ndarë në dy nivele. Niveli i parë përfshin klasën 10 dhe 11 që mundëson punësimin si punëtorë gjysmë të kualifikuar, ndërkaq niveli i dytë përfshin edhe klasën e 12-të ku punësimi në treg mundësohet si punëtorë të kualifikuar.⁵ Arsimi dhe aftësimi profesional në Kosovë synon të pajisë nxënësit me njohuri, aftësi praktike, shkathtësi dhe kompetenca të kërkua të profesione të veçanta në tregun e punës. Megjithatë, të diplomuarit e shkollave profesionale kanë mundësi të vazhdojnë arsimin e lartë njejtë sikur kolegët e tyre të diplomuar nga shkollat e mesme siç janë gjimnazet.⁶

Dallimi në mes të qendrave të kompetencës dhe shkollave profesionale

Kosova ka gjithsej katër qendra të kompetencës dhe dy shkolla të mesme të larta profesionale nën menaxhimin e Agjencisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr) që nga viti 2014.⁷ Qëllimi i qendrave të kompetencës është që të ofrohen programe që kërkohen në tregun e punës dhe të gjitha janë ngritur apo zhvilluar me anë të donacioneve dhe bashkëpjesëmarrjes nga Qeveria e Kosovës.

Dallimi në mes të shkollave të mesme profesionale dhe shkollave nën menaxhimin e AAAPARr është në nivelin e shkollimit të ofruar, ku shkollat e tjera të mesme profesionale ofrojnë më së shumti nivelin e 4 sipas kornizës kombëtare të kualifikimeve, ndërkaq qendrat e

⁴ Agjencia për Regjistrimin e Biznese në Kosovë (ARBK), Registri i Bizneseve 2016

⁵ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)<<http://bit.ly/2qsyhKZ>>

⁶ Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr), Intervistë me Ragip Gjoshi, 17 janar 2017

⁷ Shkollat profesionale publike në nivel të arsimit të mesëm të lartë profesional janë: SH.M.L.P "Shtjefen Gjeqovi" – Prishtinë; SH.M.L.T "11 Marsi" – Prizren; Qendra e Kompetencës – Prizren; Qendra e Kompetencës – Ferizaj; Qendra e Kompetencës – Malishevë; Qendra e Kompetencës – Skenderaj <<http://bit.ly/2oX1zDW>>

kompetencës janë duke u përgatitur për të ofruar edhe nivelin 5-të që është nivel post-sekondar ose terciar i arsimit që është në mes të arsimit parauniversitar dhe atij universitar. Po ashtu, qendrat e kompetencës konsiderohen si 'shkolla model' meqë është investuar më shumë në infrastrukturën e tyre dhe pajisjet që janë të disponueshme për nxënësit dhe duhet synuar zhvillimin dhe tjetërsimin edhe 65 shkollat tjera profesionale në këtë mënyrë.⁸

Sa i përket profileve, qendra e kompetencës në Ferizaj ofron profile të shërbimeve shëndetësore; ajo në Prizren ofron profile në ekonomi, tregti, turizëm dhe udhëtime; ajo në Skenderaj ofron profile në art, arkitekturë, ndërtimtari të ulët dhe të lartë, energji, klimatizim dhe mjesdis; dhe ajo në Malishevë ofron profile në ekonomi, administratë, tregti dhe toteleri. SH.M.L.P. "Shtjefën Gjeqovi" në Prishtinë ka profile në makineri, transport dhe teknikë, makineri, ndërtimtari, arte të aplikuara dhe trafik. Në të gjitha këto gjashtë institucione janë 126 mësimdhënës të lëndëve të përgjithshme, 191 mësimdhënës të lëndëve profesionale dhe 25 instruktorë. Megjithatë në qendren e kompetencës në Ferizaj dhe Skenderaj ka më shumë mësimdhënës të lëndëve të përgjithshme se të atyre profesionale.⁹

Sipas të dhënave nga hulumtimi i brendshëm i kryer nga AAAPARr mbi punësimin e të rinjve apo vazhdimin e shkollimit të lartë, nga numri i nxënësve që kanë kryer shkollimin në vitin shkollor 2014/2015 në QK - Malishevë, 40% prej tyre janë punësuar, 30% prej tyre në profesion dhe 70% prej tyre jashtë profesionit në të gjitha profilet. Për shembull, për profilin administratë dhe shërbime të zyrës janë punësuar gjithsej 30% ku 90% prej tyre janë punësuar jashtë profesionit, ndërkaq për shitje dhe marketing janë punësuar vetëm 32% e të diplomuarve e 33% e tyre jashtë profesionit. Për profilet banka dhe shërbime të sigurimeve dhe TIK, 100% të të punësuarve janë punësuar jashtë profesionit. Në SH.M.L.T. "11 Marsi" vetëm 18% e të diplomuarve janë punësuar, 19% prej tyre në profesion dhe 81% prej tyre jashtë profesionit. Vetëm 11% e të diplomuarve për arkitekturë janë punësuar dhe atë të gjithë prej tyre jashtë profesionit. Ndërkaq për dizajn grafik janë punësuar 26% e të diplomuarve, 80% e të cilëve jashtë profesionit.¹⁰

⁸ Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr), Intervistë me Ragip Gjoshi, 17 janar 2017

⁹ Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim të të Rriturve (AAAPARr), "Të dhëna statistikore gjatë fazës së pilotimit" (2016)

¹⁰ Ibid.

Vështirësia e gjetjes së punëtorëve të kualifikuar

Rezultatet e anketës tonë tregojnë se 92.6%¹¹ e bizneseve të anketuara kanë punësuar punëtorë të rinj në periudhën e fundit tre vjeçare, prej të cilave 82.1% kanë hasur në vështirësi të gjajnë punëtorë të kualifikuar. Prej tyre, 53% kanë pohuar se kjo i ka detyruar të punësojnë punëtorë më pak të kualifikuar për të plotësuar pozitat e punës dhe po ashtu 57.1% kanë pohuar se kjo ka penguar zhvillimin e shërbimeve të reja të kompanisë dhe 42.1% kanë pohuar uljen e produktivitetit ndër të tjera.



FIGURA 2. VEPŘIMET SI REZULTAT I MOS GJETJES SË PUNËTORËVE TË KUALIFIKUAR




FIGURA 3. NDIKIMI I MOS GJETJES SË PUNËTORËVE TË KUALIFIKUAR

¹¹ Shënim: Varësisht nga struktura e pyetjeve, përqindjet e interpretuara mund të janë për total pyetjen apo për një kategorji (zgjidhje) të pyetjes. Për shembull, në pytjen se si kanë vepruar kompanitë kur kanë hasur në vështirësi për gjetjen e punëtorëve të kualifikuar, të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin një apo më shumë nga kategoritë e radhitura dhe prandaj përqindjet totale të të gjitha kategorive nuk janë 100%.

Pozitat e punës më së shumti reklamohen përmes miqve (60.7%), platformave elektronike të punës (57.1%) dhe rrjeteve sociale (50%). Në të njejtën kohë, një i anketuar ka cekur edhe përdorimin e rrjetit social profesional Linkedin si një tjetër mënyrë të reklamimit të pozitave.




FIGURA 4. REKLAMIMI I POZITAVE TË PUNËS

Aftësitë e buta dhe të transferueshme janë ato aftësi që i gjejmë në pothuajse secilin konkurs të punës. Këto aftësi janë të domosdoshme për një treg të punës dinamik i cili kërkon që tërë punëtorët të jenë në hap me kohën dhe të jenë të gatshëm për ndryshime dhe zhvillim të kompetencave. Sa i përket shkallës së vështirësisë së gjetjes së punëtorëve me aftësi të buta dhe të transferueshme, 63% kanë hasur shumë në vështirësi të gjejnë punëtorë me kreativitet, 60.7% me aftësi për zgjidhjen e problemeve, 33.3% me aftësi komunikimi, 10.76% me aftësi kompjuterike, 21.4% me aftësi për t'u përshtatur në punë ekipore, dhe 7.1% kanë hasur shumë në vështirësi të gjejnë punëtorë me njohje të gjuhës angleze. Edhe pse disa nga këto përqindje tregojnë që situata nuk është edhe aq keq për gjetjen e punëtorëve me aftësi kompjuterike apo njohje të gjuhës angleze, një përqindje e lartë e të anketuarvekanë pohuar të kenë pasur pak vështirësi në gjetjen e punëtorëve me këto aftësi të cilat janë kusht për të kryer shumicën e punëve në sektorin e shërbimeve.




FIGURA 5. VËSHTIRËSIA E GJETJES SË PUNËTORËVE ME AFTËSI TË BUTA DHE TË TRANSFERUESHME

Ndërkaq kur konsiderojmë punëtorët në fillim të karrierës, është e rëndësishme dhe e pritur që ata të jenë të pajisur së paku me disa aftësi bazike të shkrimit, leximit, komunikimit dhe sjelljes. Në këtë aspekt, kompanitë e kanë pasur mesatarisht më pak vështirë të gjejnë punëtorë në fillim të karrierës me këto aftësi. Për shembull, 25.9% e kanë pasur shumë vështirë të gjejnë punëtorë që flasin në mënyrë të qartë, 33.3% të dëgjojnë me vëmendje, 15.4% të bashkëpunojnë me të tjerët, 25.9% të zgjidhin konflikte në punë dhe negocijnë, 40.7% të marrin iniciativa për të mësuar më shumë rreth punës, 3.7% të përdorin teknologjinë informative dhe 3.7% të sillen mirë me klientë.




FIGURA 6. VËSHTIRËSIA E GJETJES SË PUNËTORËVE ME AFTËSI BAZIKE

Kualifikimet e punëtorëve shërbejnë si një dëshmi për posedimin e aftësive profesionale të caktuara. Si të tilla, shumë nga punëdhënësit në termat e referencës së pozitave të punës radhisin edhe nivelin e shkollimit që preferohet për një pozitë të caktuar. Në sektorin privat vërehet një tendencë që jo për çdo lloj pune kërkohet shkollim i përcaktuar, por fokusohen më tepër në aftësitë që nevojiten për kryerjen e detyrave të cilat mund të dëshmohen vetëm me punë pavarësisht certifikatave apo diplomave të poseduara.

Në anketë kemi pyetur punëdhënësit se çfarë niveli të shkollimit kërkojnë për sa përqind të pozitave në kompaninë e tyre. Në interpretimin e këtyre rezultateve duhet cekur se ka raste kur një punëdhënës është shprehur se për 100% të pozitave kërkohet së paku shkolla e mesme, ndërsa në të njejtën kohë ka cekur se për 25% të pozitave kërkohet edhe ndonjë lloj tjetër shkollimi.

Si rrjedhojë, 25% prej të anketuarve kanë thënë se për 100% të pozitave të tyre nuk ka nevojë patjetër që punëtorët të kenë shkollim formal. Për 75% të pozitave të 35.3% të kompanive nevojiten diploma profesionale apo certifikata trajnimesh. Diploma e shkollës së mesme është e domosdoshme për të gjitha pozitat në 40% të kompanive, ndërsa

shkolla e mesme profesionale nevojitet për të gjitha pozitat në 20% të kompanive. Sa i përket kualifikimeve të nivelit bachelor dhe master, rreth 30% e kompanive i kërkojnë këto nivele për gjysmën e pozitave në kompani. Ndërsa sa i përket nivelit të doktoraturës, vetëm 5.6% e kompanive kanë nevojë për gjysmën e punonjësve me këtë nivel të shkollimit.




FIGURA 7. KËRKESAT E KOMPANIVE PËR NIVELIN E SHKOLLIMIT NË RAPORT ME PËRQINDJEN TOTALE TË POZITAVE NË KOMPANI

Sa i përket vështirësisë së gjetjes së punëtorëve me diploma, 26% e punëdhënësve e kanë shumë të vështirë të gjejnë punëtorë me diploma profesionale apo certifikata nga trajnimet. Në këtë lloj kualifikimi janë grupuar të gjitha format e diplomave profesionale të cilat kanë lënë të nënkuftohen edhe specializimet profesionale posdiplomike edhe shkollat e mesme profesionale. Kjo reflektohet tek përgjigja e radhës kur flasim për pozitat që kërkojnë diplomat e shkollës së mesme ku vërehet se vetëm 4% e kanë shumë të vështirë të gjejnë punëtorë me këtë kualifikim. Sa i përket nivelit bachelor 4% e punëdhënësve e kanë shumë vështirë të gjejnë punëtorë të kualifikuar me bachelor, gjegjësisht 12% me master. Ndërkaq, 48% e punëdhënësve e kanë shumë të vështirë të gjejnë dikë të përshtatshëm me diplomë doktorature.




FIGURA 8. VËSHTIRËSIA E GJETJES SË PUNËTORËVE ME KUALIFIKIMET E CAKTUARA

Janë 81.5% e kompanive të cilët kanë pohuar se ofrojnë trajnime për punëtorët e tyre duke radhitur si arsyet kryesore për ofrimin e trajnimeve rritjen e cilësisë së produkteve apo shërbimeve (73.1%), rritjen e produktivitetit të punëtorëve (50%), rritjen e konkurrencës në treg si dhe zhvillimin personal dhe profesional të punëtorëve (46.2%).






FIGURA 9. ARSYET PËR OFRIMIN E TRAJNIMEVE

Sa i përket mënyrave dhe institucioneve të përdorura për trajnime, të anketuarit cekin se kryesisht marrin pjesë në trajnimet e përgatitura nga biznese të ndryshme apo kontraktorë trajnerë enkas për punëtorët e tyre, ndërkëq asnjë nuk ka pohuar se ka bashkëpunuar me ndonjë qendër apo shkollë profesionale për të trajnuar punëtorët.

**FIGURA 10.** INSTITUCIONET E SHFRYTËZUARA PËR TRAJNIM

Në fakt, 77.7% e të anketuarve dijnë për ekzistencën e shkollave profesionale, por 22% e tyre nuk do t'i punësonin personat vetëm me shkollë profesionale disa prej të cilëve besojnë që nivel i aftësimit profesional është shumë i ulët apo, sepse, për pozitat e punës në kompani nevojitet diplomë universitare. Ndërkaq 45% e tyre janë shprehur që do t'i punësonin personat vetëm me shkollë profesionale në rast se këto shkolla profesionale do të prezantonin kandidatë të perqatitur shumë mirë për tregun e punës me njohuritë dhe aftesitë e duhura. Për 33% të të anketuarve, kjo pyetje nuk ishte e aplikueshme meqë kërkesat për shkollimin e punëtorëve në kompaninë e tyre janë në nivel të arsimit të lartë.

**FIGURA 11.** PUNËSIMI I TË RINJVE QË E KANË TË PËRFUNDUAR VETËM SH.M. PROFESIONALE

Kërkesat për trajnimin e punëtorëve që mbajnë pozita menaxheriale, profesionale apo administrative janë rritur për 38.5%, 73.1% dhe 34.6% të kompanive, respektivisht. Për shumicën e kompanive janë rritur kërkesat për trajnimin e pozitave profesionale, kjo sepse ndryshimet kryesore qëndrojnë tek mjetet e reja të përdorimit qoftë softuerë, harduerë, apo edhe infrastrukturë tjetër varësisht nga fushëveprimtaria e kompanive.




FIGURA 12. RRITJA E KËRKESAVE PËR TRAJNIMIN E POZITAVE MENAXHERIALE, PROFESIONALE DHE ADMINISTRATIVE

Kompanitë pohuan rritjen më të madhe të kërkesave për trajnime profesionale, gjë që mesatarisht ka reflektuar edhe te ofrimi i trajnimeve për këto pozita. Krahas rritjes së kërkesave, 31.8% e kompanive nuk kanë trajnuar asnjë përqind të pozitave menaxheriale, por 18.2% e të anketuarve janë përgjigjur që kanë trajnuar gjysmën e pozitave menaxheriale. Ndërkaq, 8.3% kanë thënë se nuk kanë trajnuar asnjë përqind të pozitave profesionale e në të njejtën kohë nga 29.2% e të anketuarve kanë thënë se kanë trajnuar gjysmën apo 75% të pozitave profesionale. Sa i përket pozitave administrative, 44% kanë mohuar të kenë trajnuar këto pozita, por 24% e të anketuarve kanë thënë se kanë trajnuar gjysmën e pozitave administrative në kompani. Një numër më i vogël i kompanive ofron rimbursime për trajnime profesionale nëse ato trajnime nuk i kanë paraparë vetë.




FIGURA 13. PËRQINDJA E TRAJNIMEVE TË OFRUARA NË RAPORT ME PËRQINDJEN TOTALE TË POZITAVE MENAXHERIALE, PROFESIONALE DHE ADMINISTRATIVE

Aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave sipas profesioneve

Pjesa e raportit rreth aftësive të nevojshme për kryerjen e detyrave sipas profesioneve thekson gjetjet kryesore rreth asaj se nëse një detyrë kërcohët të bëhet për një pozitë të caktuar, ku është zhvilluar aftësia për kryerjen e asaj detyre. Varësisht nga fushëveprimtaria e kompanisë, detyrat dhe aftësitë e kérkuara për pozita të njejtë dallojnë nga kompania në kompani. Tabelat e detajuara për 24 pozitat e përzgjedhura për hulumtim gjenden në shtojcë.

Zgjedhjet për pohimin apo mohimin e kryerjes së detyrës janë:

PO – Aftësia për ta kryer detyrën:

- Është mësuar gjatë shkollimit
- Është mësuar gjatë punës
- Është përfocuar gjatë punës
- Është krijuar nga shkollimi dhe puna së bashku

JO – Aftësia për ta kryer detyrën:


- Është e panevojshme
- Nuk është mësuar as në shkollë as në punë

Për të shumtën e rasteve, opzioni për aftësitë të cilat janë të panevojshme i referohet faktit që ka punëtorë të tjerë që merren me atë detyrë, apo kompania nuk ka nevojë për ato detyra për shkak të llojit dhe madhësisë.

Në përgjithësi, aftësitë e duhura për kryerjen e detyrave për të gjitha pozitat, më së shumti konsiderohet të jenë mësuar si kombinim i shkollimit dhe punës, të jenë përfocuar gjatë punës, apo të jenë të panevojshme, por vetëm për 16.7%, apo 4 nga 24, pozitat e përzgjedhura, aftësitë për kryerjen e disa detyrave janë mësuar në shkollë.

Aftësitë për kryerjen e detyrave nga **drejtorët ekzekutivë** në përgjithësi duket të jenë përfocuar gjatë punës apo të jenë krijuar nga shkolla dhe puna së bashku, por rrallëherë të jenë mësuar vetëm gjatë shkollës. Për shembull, aftësitë për planifikimin dhe udhëheqjen e kompanisë, në 64.7% të kompanive të cilat kanë këtë pozitë janë krijuar nga shkollimi dhe puna së bashku, ndërkaq në 5.9% të këtyre kompanive aftësia për kryerjen e kësaj detyre është e panevojshme. Në rastet kur kompania nuk ka këtë titull për pozitën e cila përshkruan detyrat si në tabelën përkatëse, titujt për pozitat ekuivalente janë: Themelues/e dhe Menaxher/e i/e Përgjithshëm/Përgjithshme si dhe Kryeshek/e Ekzekutiv/e.

Rezultate të ngjashme vlejnë edhe për aftësitë për kryerjen e detyrave nga **menaxherët financiarë** ku dominojnë zgjidhjet që shfaqin



përforcimin e aftësive gjatë punës apo krijimin e tyre së bashku përmes shkollës dhe punës. Për shembull, aftësitë për planifikimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve të përditshme financiare, për 58.3% të kompanive në fjalë janë krijuar nga shkollimi dhe puna së bashku, ndërsa për 8.7% të tyre këto aftësi janë të panevojshme për këtë pozitë. Pozitat ekuivalente me tituj të ndryshëm në kompanitë e anketuara janë: Drejtor/eshë i/e Departamentit të Financave, Menaxher/e i/e Operimeve dhe Shtijes, Menaxher/e i/e Projekteve, Menaxher/e i/e Financave dhe Administratës, Drejtor/eshë Financiar/e, Menaxher/e i/e Pergjithshëm/ Përgjithshme, Kryeshek/e Financiar/e.

Për **menaxherët e shitjes dhe marketingut**, aftësia për planifikimin e organizimin e aktiviteteve të marketingut bazuar në të dhënrat e shitjeve dhe vlerësimit të tregut është krijuar nga shkollimi dhe puna për 60% të kompanive me këtë pozitë. Sa i përket përcaktimit të listave tw çmimeve, kushteve të zbritjeve dhe dérgesave, buxhetit për promovim, metodave të shitjes si dhe organizimit të fushatave, 55.6% e këtyre kompanive thonë se aftësitë për kryerjen e këtyre detyrave janë krijuar nga puna dhe shkolla së bashku, por 11.1% prej tyre pohojnë që për këtë pozitë aftësitë për krijimin dhe menaxhimin e procedurave administrative të departamentit janë të panevojshme. Pozitat ekuivalente me kryerjen e këtyre detyrave në kompanitë e anketuara janë: Drejtor/eshë e Departamentit të Shitjes, Menaxher/e i/e Shitjes, Kryeshek/e Ekzekutiv/e, Menaxher/e i/e Marketingut, Menaxher/e i/e Shitjes, Udhëheqës/e e Departamentit për Komunikim.

Për **dizajnerët grafikë**, aftësia për të përgatitur skica, diagrame dhe ilustrime për temën që do të komunikohet tek grupi i targetuar, në 28.6% të kompanive me këtë pozitë thuhet se janë përforcuar gjatë punës, në 57.1% të kompanive janë krijuar nga shkollimi dhe puna së bashku dhe për 14.3% të kompanive janë të panevojshme. Pozitat ekuivalente me kryerjen e këtyre detyrave në disa nga kompanitë janë: Zhvillues/e i/e Uebit dhe Softuerëve apo dhe Drejtor/eshë Kreativ/e.

Për **intervistuesit e anketave dhe të hulumtimit të tregut**, mësimi i aftësive për kryerjen e detyrave për disa nga kompanitë vlerësohet të jetë bërë edhe gjatë mësimit, gjë që për shumicën e shembujve më lartë nuk vlen. Për shembull, aftësia për të kontaktuar individët me telefon ose personalisht dhe për të shpjeguar qëllimin e intervistës për 16.7% të kompanivë është mësuar gjatë shkollimit, për 33.3% të kompanive është mësuar gjatë punës, për 33.3% të kompanive është përforcuar gjatë punës dhe për 16.7% të kompanive është krijuar nga puna dhe shkollimi së bashku. Tituj të tjera të kësaj pozite në disa nga kompanitë janë: Anketues/e, Hulumtues/e në terren, Zyrtar/e i/e Projekteve, Koordinator/e i/e Projekteve, Asistent/e i/e Projekteve.

Detajet e pozitave të tjera gjenden në shtojcën e këtij studimi.

Aftësitë më të kërkuara në industrinë e shërbimeve


Identifikimi i aftësive më të kërkuara nga punëdhënësit është gjëja kryesore dhe më e rëndësishme për çdo vend, e sidomos për vendet në zhvillim të cilat kanë probleme me implementimin e programeve arsimore të duhura. Rrjeti social profesional Linkedin çdo vit bën analiza për aftësitë më të kërkuara nga anëtarët e vet, duke grupuar aftësitë me karakteristika të njejtë në një kategori. Anëtarët e Linkedin në profilet e tyre mund të radhitin aftësitë të cilat i posedojnë ku pastaj anëtarë të tjerë mund t'ua vërtetojnë ato aftësi duke klikuar në 'vërteto' (endorse). Në këtë mënyrë rekrutuesit mund të kërkojnë punëtorë me aftësitë që ata kanë nevojë në kompanitë apo organizatat e tyre.

Në vitin 2016, aftësitë më të kërkuara në Linkedin ishin ato të shkencave kompjuterike, specifisht të 'sistemit të shpërndarjes' (cloud and distributed computing) që nënkupton shpërndarjen e informatave në rrjete të ndryshme që janë të vendosura në vende të ndryshme; bërja e analizave statistikore dhe nxjerra e të dhënavë; njojja e arkitekturës së rrjeteve dhe kornizës për zhvillim; njojja e softuerëve që shërbejnë si urë lidhëse në mes të një sistemi operativ dhe aplikacioneve (middleware and integration software); dizajnimi i ndërfaqes së përdoruesit (user interface design); sigurimi i rrjeteve dhe informatave; zhvillimi i celularëve; prezantimi i të dhënavë; marketingu përmes motorëve të kërkimit (reklamat e uebit apo rrjeteve të tjera të një kompanie të iu dalin të parat përdoruesve që kërkojnë në motorët e kërkimit si Google, etj); sistemet e ruajtjes dhe menaxhmenti.

Identifikimi i aftësive më të kërkuara në Kosovë për të gjitha industritë është i domosdoshëm. Edhe pse ende nuk ekzistojnë rrjete sociale profesionale si Linkedin, Kosova ka një sërë portalesh pune siç janë HeadHunter, Portal Pune, KosovaJobs dhe HumanPower, të cilat mund të zhvillojnë sisteme për mbledhjen e të dhënavë të aftësive më të kërkuara nga punëdhënësit që përdorin këto portale të rekrutimit për të parë edhe më saktë e në kohë reale se posedimi i cilave aftësi do t'i punësonte të papunët apo ata që dëshirojnë të avancohen në karrierë.

Përmes anketës tonë, kemi marrë një rezultat të përgjithshëm mbi aftësitë më të kërkuara në Kosovë në disa sektorë ekonomikë të industrisë së shërbimeve. Sipas mendimit të të anketuarve, disa nga aftësitë më të kërkuara janë:

- Njojja e gjuhëve të huaja
- Dhënia e shpejtë e informatës
- Aftësi analitike
- Aftësi menaxheriale
- Aftësi për menaxhim të projekteve
- Aftësi profesionale/teknike



- Mendimi kritik
- Aftësi financiare
- Aftësi komunikimi
- Aftësi për zhvillim të aplikacioneve softuerike
- Mendimi logjik
- Aftësi ligjërimi
- Aftësi për zgjidhjen e problemeve
- Aftësi auditimi
- Aftësi veticinuese
- Aftësi udhëheqësie/drejtuese
- Kreativiteti
- Vlerësimi i pasurisë
- Aftësi këshillimi
- Aftësi prezentuese
- Aftësi për organizimin e aktivitetave promocionale
- Aftësi të shkrimit akademik
- Aftësi për këshillim tatimor
- Aftësi për të punuar në ekip
- Aftësi hulumtimi
- Aftësi për përdorimin e teknologjisë informative
- Aftësi për shkrimin e raporteve
- Aftësi për menaxhimin e rrjetave sociale
- Aftësi të shitjes
- Aftësi të gjithanshme

Disa nga aftësitë e lartë radhitura nga kompanitë e anketuara të Kosovës ndërlidhen edhe me të gjeturat e Linkedin si për shembull aftësitë për zhvillimin e aplikacioneve softuerike, menaxhimin e rrjetave sociale si pjesë e marketingut si dhe aftësitë analitike, të prezentimit dhe të shitjes ndër të tjera. Grupet e aftësive profesionale apo tekniqe nuk kërkojnë nga tërë punëtorët siç janë për shembull hulumtimi, organizimi i aktivitetave promocionale, apo njohuritë e gjera financiare, mirëpo këto janë të domosdoshme për hulumtues të fushave të ndryshme, reklamues apo zyrtarë të marketingut, financierë, kontabilistë apo auditorë. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm në këtë grup aftësish janë të aplikueshme dhe të përgjithshme pothuajse për të gjithë punëtorët në industrinë e shërbimeve siç janë njohja e gjuhëve të huaja të caktuara, dhënia e shpejtë e informatave, përdorimi i teknologjisë informative, veticinativa, puna në ekip, të menduarit kritik e logjik, kreativiteti e po ashtu lehtësia në komunikim me të tjërët.

Kompanitë mendojnë që këto aftësi janë më të kërkuarat për shkak të kërkesave nga tregu i jashtëm, kërkesave të klientëve për sigurim të cilësisë, kërkesat për shfaqjen e profesionalizmit dhe korrekësisë në blerjen e shërbimeve apo produkteve, zhvillimi personal dhe profesional i punëtorëve si një gjë kyçe për zhvillimin e kompanisë. Po ashtu, aftësitë profesionale të radhitura janë të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve të sektoreve ku operojnë kompanitë e tyre.

Rast studimi - Baruti GmbH

Kompania Baruti është themeluar në vitin 2011/2012 duke filluar operimin me vetëm 7 punëtorë. Që atëherë, Baruti ka arritur të dyzetfishojë numrin e punëtorëve duke tërhequr çdo herë e më shumë klientë nga vendet gjermano-folëse. Përveç kësaj, përmes rrjeteve sociale, Baruti ka arritur të tërheq vëmendjen e mediave si dhe të njerëzve të rëndomtë duke paraqitur profilet e punonjësve ku shfrytëzon rastin t'i falenderojë dhe t'i urojë për arritjet e tyre. Baruti po ashtu është një ndër ndërmarrjet me më së shumti konkurse pune ku kërkohen numër i madh i punëtorëve. Të trija këto komponente kanë bërë Barutin një ndërmarrje të suksesshme dhe prandaj është zgjedhur si rast studimi për këtë hulumtim.

Baruti është kompani që ofron shërbime të qendrave të thirrjes për vendet gjermano-folëse edhe pse pritet që ta zgjerojë tregun edhe në vendet anglisht-folëse. Baruti është shembull i një kompanie të suksesshme e cila vazhdimesht bazohet në ripërtitje të njohurive, ngritje të kompetencave dhe avansim të punëtorëve të vet.

Baruti ofron shërbime klasike të qendrave të thirrjes përfshirë mbështetjen telefonike ndaj konsumatorit, menaxhimin e ankesave të konsumatorëve, dhe hulumtime të tregut.

Shërbimet e Barutit janë të ndara në tre sektorë:

- Sektori i brendshëm (Inbound) nënkupton që shumica e telefonatave vijnë nga konsumatorët e klientëve të Barutit për të marrë informata të nevojshme si për shembull rrëth çmimeve të produkteve, vendndodhjes së dërgesave të tyre apo edhe për të bërë ankesa. Informatat pastaj përcillen tek klientët përkatës.
- Sektori i jashtëm (Outbound) nënkupton që shumica e telefonatave bëhen nga agjentët e Barutit në emër të klientëve të tyre tek konsumatorët e këtyre të fundit për të njoftuar ata me ndryshime në produkte, në kohën e dërgesave, apo edhe për t'i njoftuar për oferta të reja në treg.
- Sektori i hulumtimit të tregut merret me matjen e kënaqësisë së konsumatorëve për lansimin e një produkti të ri në treg me qëllim që të analizohen konsumatorët, tregu dhe konkurrenca në mënyrë që të mundësohen veprime të planifikuara të kompanisë.

Baruti merret vetëm me ekzekutimin e anketave dhe ofrimin e shërbimeve të tjera, ndërkundje krijimin e anketave e bëjnë vetw klientët. Kompania është e certifikuar me dy standarde evropiane me ISO 27001:2005 që ka të bëjë me menaxhimin e sistemit te sigurisë së informatave dhe ISO 9001:2015 që ka të bëjë me menaxhimin e sistemit të cilësisë. Prandaj, Baruti nuk ruan asnjë informatë në serverin lokal

duke mos paraqitur problem me mbrojtjen e të dhënave, sepse janë klientët ata që mbrojnë të dhënat dhe informatat e të anketuarve.

Përberja e kompanisë

Baruti ka 286 punëtorë, ku 133 prej tyre janë gra dhe 153 prej tyre janë burra. Për rekrutim të punëtorëve, kompania përdor platformat elektronike të punës, rrjetin social Facebook dhe kontakton universitetet apo kolegjet. Për shkak të volumit të punës, Baruti punëson rreth 15-20 punëtorë çdo muaj.


Pozitat aktuale në Baruti janë:

- Kryeshef/e Ekzekutiv/e
- Udhëheqëse i/e Departamentit
- Menaxher/e i/e Divizionit
- Udhëheqës/e i/e Ekipit
- Menaxher/e ISO
- Zyrtar/e për Marketing dhe Shitje
- Rekrutues/e
- Zyrtar/e për Trajnim dhe Zhvillim
- Koordinator/e i/e Trajnimeve
- Kontrollues/e i/e Cilësisë
- Asistent/e Ekzekutiv/e
- Administrator/e i/e Sistemit
- Mbështetje e TI-së
- Recepzionist/e
- Operator/e telefonik/e

Kualifikimet dhe aftësitë e punëtorëve

Në rekrutimin e punëtorëve, Baruti kërkon një sërë aftësish, porkushti kryesor për të punuar në këtë kompani është njojja e gjuhës gjermane. Sa i përket kualifikimeve preferohen të diplomuarit e nivelit universitar dhe master, por Baruti nuk ka praktika diskriminuese në rekrutim edhe ndaj personave që kanë kryer trajnime profesionale qoftë përmes sektorit privat apo edhe institacioneve publike e të cilët dëshmojnë posedimin e aftësive që kerkohen për pozitat e caktuara. Por, edhe kjo kompani ka hasur në vështirësi në gjetjen e punëtorëve me aftësi të ndryshme siç janë aftësitë e buta, aftësitë në përdorimin e pakos Microsoft Office, në drejtshkrimin e gjuhës gjermane nga operatorët telefonikë, në marrjen e iniciativës për të punuar në mënyrë autonome, në paraqitje apo prezantim përpara klientëve si dhe në negociim.

Vështirësitë kanë bërë që të rriten përprjekjet për rekrutim, të rriten pagat për të térhequr më shumë aplikantë, por në të njejtën kohë kanë penguar edhe zhvillimin e shërbimeve të reja të kompanisë.



Trajnimet brenda dhe jashtë kompanisë

Baruti vazhdimesh ofron trajnime të brendshme dhe të jashtme për tërë personelin. Trajnimet e brendshme kryesisht bëhen prej vetë punëtorëve me përvojë më të madhe apo të cilët kanë arritur të bëhen udhëheqës të ekipeve apo edhe të marrin pozita të tjera ku aftësitë e përvetësuara në secilën pozitë ua transefrojnë njëri tjetrit. Trajnimet ofrohen për të promovuar zhvillimin personal dhe profesional të punëtorëve, për të rritur produktivitetin e punëtorëve, për të rritur cilësinë e punës, për të ndihmuar punëtorët që të zhvillojnë shprehi pune më të mira dhe qëndrim pozitiv si dhe për të qenë në të njëjtin nivel me konkurrencën jashtë vendit.

Trajnimet e jashtme kanë qenë në menaxhim të projekteve, komunikimit efikas, menaxhim të resurseve njerëzore, trajnim në udhëheqësi si dhe trajnim për përdorimin e pakos Microsoft Office në nivel të avancuar. Sa i përket përfituesve të këtyre trajnimeve, mesatarisht 70% e pozitave menaxheriale, 60% e pozitave administrative si dhe 40% e pozitave profesionale trajnohen.

Përfundime dhe rekondime

